

PUNIM UDHËZUES

Qasja Alternative për Energjinë

Qershor 2011

Qasja Alternative për Energjinë

Hyrje

Në këtë numër

1. Fuzionimi i sistemeve energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë

2. Projekti i ngrohtoreve që furnizohen me avull nga TC Kosova – B

3. Implementimi i masave për eficiencë energjetike

4. Humbjet komerciale dhe teknike

5. Ndërtimi i kapaciteteve të reja të mbeshtetura në energji të ripërtëritshme

Sektori i energjetikës, e posaçërisht ai i prodhimit të energjisë elektrike, vazhdon të jetë njëri ndër sektorët që paraqesin problem serioz për Kosovën. Konsumatorët, si amvisëritë ashtu dhe bizneset, përballen me furnizim jocilësor dhe jostabil të energjisë elektrike, e cila është shndërruar në barrierë për zhvillimin ekonomik të vendit. Si pasojë e trajtimit jo të duhur të këtij sektori, krahas humbjeve të mëdha teknike dhe komerciale dhe rritjes së kërkesës, Kosova vazhdon të jetë vendi me varshmërinë më të lartë në rajon nga importi i paplanifikuar i energjisë elektrike. Në krahasim me vitin 2009, Kosova në vitin vijues ka rritur importin e energjisë elektrike për afër 6% dhe këtë vit pritet një rritje edhe më e madhe e importit (Ministria e Administrimit Publik 2011).

Gjenerimi i energjisë elektrike dhe ai i projeksionit të kërkesës dhe ofertës për energji është dhe do të jetë njëri ndër sfidat më të mëdha të Kosovës. Nga diskutimet publike deri më tani lidhur me këtë çështje, është krijuar përshtypja se mënyra e vetme për të dalë nga kjo situatë është përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese të bazuara në linjit. Pas këtij konstatimi, problemi kufizohet vetëm në përcaktimin e madhësisë së kapaciteteve: pra se a do të jenë prej 2100, 1000 apo 600 MW pa lënë hapësirë për trajtim më gjithëpërfshirës të kësaj çështjeje.

Kjo qasje, në parim deduktive, e trajtimit nga fundi krijon një përshtypje se të gjitha zgjidhjet tjera kanë më tepër karakter polemizues dhe se në instancën e fundit konstatimi mbetet prapë i njëjtë, se kapacitetet gjeneruese të bazuara në linjit janë zgjidhja e vetme. Pa e kontestuar nevojën urgjente për ndërtimin e kapaciteteve të reja në bazë të linjtit, ne konsiderojmë se çështja e energjisë duhet shtruar pak më ndryshe dhe në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Një qasje induktive do të qartësonte edhe hapat përcjellës që duhen ndërmarrë krahas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese.

Së pari, duhet të krijohet një bazë e aprovueshme dhe kredibile e të dhënave për nevojat për energji në së paku pesë segmente të konsumit: Amvisëri, Industri, Transport, Bujqësi dhe Shërbime për 10 deri në 20 vitet e ardhshme. Në mungesë të strategjisë së përgjithshme zhvillimore, Kosovës i mungojnë projeksionet e kërkesës për energji elektrike dhe burimeve alternative gjeneruese për të përmbushur këtë kërkesë. Në një situatë të tillë, diskutimet dhe vendimet për kapacitetet e reja të bazuara në linjit janë plotësisht arbitrare. Edhe pse autorët njohin rëndësinë e madhe të këtyre të projeksioneve, kjo çështje nuk do të jetë temë boshte e trajtimit të këtij punimi.

Së dyti, duhet vlerësuar se cilat janë ato veprime dhe masa që menjëherë do të duhej të ndërmerreshin e që do të ndikojnë në përmirësimin e bilancit ndërmjet kërkesës dhe ofertës për energji. Hapat kryesor që duhet të ndërmerren janë:

1. Fuzionimi i sistemeve energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë
2. Sistemi i ngrohtoreve për ngrohje qendrore dhe ujë të ngrohtë
3. Implementimi i masave për efikasitet energjetike
4. Minimizimi i humbjeve komerciale dhe teknike
5. Ndërtimi i kapaciteteve të reja të bazuara në energji të ripërtëritshme

Në vazhdim, do ti trajtojmë në mënyrë më të detajuar këta hapa të cilat nuk janë radhitur sipas rëndësisë, pasi që të gjitha kanë prioritet të njëjtë. Ne argumentojmë se këta hapat duhet të ekzekutohen njëkohësisht dhe se përparimi në këto drejtime e bën më të lehtë vendimmarrjen e qeverisë lidhur me kapacitetet optimale gjeneruese të bazuar në thellësi që duhet t'i krijoj Kosova.

1. Fuzionimi i sistemeve energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë

Fuzionimi i sistemeve energjetike në mes Kosovës dhe Shqipërisë do të përmirësoj gjendjen energjetike në dy vendet

Ekziston një konsensus i përgjithshëm se krijimi i një tërësie energjetike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është i leverdishëm për të dyja vendet dhe rritë stabilitetin teknik të njejeve shpërndarëse në Ballkan. Fuzionimi i sistemeve energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë duhet të nxisë rristurimin dhe riformulimin e politikave të deritanishme energjetike në këto dy vende dhe në vendet e rajonit. Fillimi i ndërtimit të largpërçuesit Kosovë – Shqipëri paraqet një hap para në këtë drejtim, mirëpo fuzionimi i nevojshëm dhe sinergjia e pritur nuk realizohet vetëm përmes ndërtimit të largpërçuesit 400 kV. Përdërsa ky i fundit është një parakusht infrastrukturor që do të mundësojë funksionimin teknologjik të një strukture unike të re, efektet e pritura nga ky unifikim duhet të dëshmojnë dhe prezantohen përmes përmirësimit të dokumenteve strategjike.

Në këtë kuadër, së pari duhen hartuar bilanci energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë për 10 vitet e kaluara me tabelat përkatëse të prodhimit, importit, eksportit të zbërthyer sipas vendeve në rajonin e Ballkanit dhe atë në nivelin mujor. Nga këto të dhëna do të mund të argumentohet se në periudhën dimërore në vend që të importohet energji elektrike nga vendet tjera rajonale, Kosova do të mund të shfrytëzonte energjinë e tepërt nga Shqipëria. Aktualisht, këtë energji Shqipëria e eksporton në kushte të pavolitshme nga se nuk mund të planifikojë kërkesën në periudhë afatgjate. Në anën tjetër, në periudhën e thatësirave, në mungesë të kapaciteteve ujore, Shqipëria do të mund të importonte nga Kosova. Në këtë periudhë, Kosova me lehtësi mund të eksportojë në Shqipëri tepërcat e energjisë elektrike të prodhuar nga termoelektranat, e të cilat për shkak të njëjta nuk mund t'i plasojë ë treg me kushte të volitshme.

Së dyti, pas hartimit të këtyre balancave energjetike, duhet të nxirren informata për humbjet si në furnizim ashtu edhe në çmim të energjisë elektrike për shkak të funksionimit të ndarë të sistemeve energjetike. Kjo analizë do të qartësonte nivelin e kursimit dhe të përmirësimit të furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike sikur ky sistem do të funksiononte si një sistem unik. Për më tepër, do të qartësoheshin efektet e përmirësimit dhe ngritjes së nivelit të stabilitetit të sistemit për shkak të veprimt të unifikuar të dy sistemeve energjetike i cili mund të

2. Projekti i ngrohtoreve që furnizohen me avull nga TC-Kosova B

Projekti i ngrohtoreve që furnizohen me avull nga TC-Kosova B ka kohë që është vlerësuar me rëndësi të veçantë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të sektorit të energjisë. Për këtë projekt, së paku në suaza të qytetit të Prishtinës, është përmbyllur edhe konstruksioni financiar¹. Furnizimi i drejtpërdrejt i avullit nga TC, nga sistemi i kondensimit në procesin e këmbimit në ngrohtoret e qytetit paraqet një transformim jashtëzakonisht të volitshëm të energjisë së avullit. Sigurimi i ngrohjes dhe ujit të ngrohtë do ta reduktojë dukshëm konsumin e energjisë elektrike dhe konsumin e drurit dhe do të zbushte kërkesën për energji elektrike sidomos në periudhat e ftohta. Sipas raporteve dhe rezultatet të balancave energjetike të viteve të pasluftës del se sektori dominues i konsumit të energjisë është ai familjar. Në këtë sektor, përdorimi i energjisë elektrike bëhet kryesisht për ngrohje, higjienë dhe gatim.

Sipas Riinvest (2008-2010), nga këto tri aktiviteti 80% e energjisë shpenzohet për ngrohje gjatë kohës së ftohtë dhe ngrohjes së ujit. Prandaj projekti në fjalë duhet të zhvillohet dhe zgjerohet në dy rrafshë:

1. Në rrafshin e parë, atë funksional, fillimisht (i) përmes ndërtimit të ngrohtoreve qendrore dhe (ii) ngrohjen e ujit për amvisëri gjatë tërë vitit. Kurse,
2. Rrafshi i dytë është ai gjeografik. Projekti duhet të shtrihet në tërë Kosovën. Natyrisht në faza dhe me plan kohor përkatës. Nga analizat e arsyeshmërisë së projekteve të ngjashme del se investimi në sistemet e ngrohjeve qendrore është më i leverdishëm në qendra urbane me ndërtime të larta. Megjithatë, ne mendojmë se duhen bërë investimet në sistemet e ngrohjeve qendrore edhe në rajonet me ndërtime të ulëta dhe të shpërndara, pasi që përfitimet afatgjata tejkalojnë shpenzimet fillestare. Për më tepër, këto sisteme përdorin energjinë e avullit, e cila në rast të mosshfrytëzimit, thjeshtë do të humbiste.

Çështja e ngrohjeve qendrore me avull nga TC duhet të trajtohet si projekt afatgjatë dhe të cilit duhet t'i paraprijë një vlerësim gjithëpërfshirës për të dy rrafshet e zgjerimit të tij të diskutuara më sipër. Funksionalizimi i ngrohtoreve që furnizohen me avull nga TC ndikon në kursimin e energjisë elektrike e cila do të jetë në dispozicion për funksionet dhe konsumet.

3. Implementimi i masave për efikasitet energjetike

Reduktimi i konsumit të energjisë elektrike nëpër sektorë të ndryshëm në Kosovë është parakusht për vendimarrje të drejta lidhur me nivelin e kapaciteteve të reja gjeneruese të bazuara në linjit. Kjo vendimarrje bëhet edhe më e rëndësishme kur kemi parasysh efektet anësore që këto kapacitete gjeneruese kanë në aspektin e emetimit të CO_x, SO_x dhe ndotësve të tjerë të ambientit.

Masa për shpenzim me efikasitet të energjisë elektrike janë ndërmarr në shumë vende të botës. Sidomos në vende të zhvilluara ku theks i veçantë, përveç përmirësimit të legjislacionit, i është dhënë rritjes së vetëdijes qytetare dhe skemave tjera stimuluese për shpenzim efikasitet të energjisë. Edhe në Kosovë, si shtet në zhvillim, duhet të punohet më shumë në këtë drejtim në mënyrë që të arrihen rezultate të cilat janë evidente në vendet që promovojnë këto masa.

Meqë në Kosovë sektorët siç janë bujqësia dhe transporti, në masë të madhe, nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me energjinë elektrike që prodhohet nga termoelektranat e Kosovës, atëherë sektorët në të cilët ne duhet të fokusohemi më shumë në reduktimin e shpenzimit të energjisë elektrike janë sektorët e amvisërisë, industrisë dhe ndërmarrjeve komerciale, të cilat respektivisht përbëjnë 55%, 16%, 7% të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike në vend (Berisha 2010).

Implementimi i masave Eficiente është parakusht për vendimarrje të drejta lidhur me nivelin e kapaciteteve të reja

Në paragrafët e mëposhtëm do të përshkruajmë disa nga mënyrat se si në sektorët e lartpërmendur mund të arrijnë një reduktim të madh të konsumit të energjisë. Renditja e këtyre masave për efikasitet energjetike nuk është bërë sipas rëndësisë.

Me zëvendësimin e të gjithë poçave të zakonshëm me ata eficient do të kursen 14 milion Euro në vit.

a) Poçat Eficient. Nëse të gjithë poçat e zakonshëm në amvisëri dhe në sektorët tjerë zëvendësohen me ata ekonomike/eficiente, atëherë afërsisht 70% e energjisë elektrike që shpenzohet për ndriçim do të kursehej. Sipas Riinvest (2009), nëse vetëm në sektorin e amvisërisë të gjithë poçat e zakonshëm zëvendësohen me poça eficientë, atëherë konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike do të zvogëlohej me rreth 5.6%. Në terma monetarë, kjo përkthehet në afërsisht 14 milion euro kursim të energjisë elektrike nga amvisëria në vit. E nëse përfshihen edhe sektorët e tjerë përqindja e kursimit mund edhe të dyfishohet. Kostoja fillestare e poçave eficient është më e madhe në krahasim me poçat e zakonshëm, por edhe jetëgjatësia e tyre është më e madhe për aq herë sa është edhe kostoja. Sipas një studimi të bërë nga Universiteti i Bochumit (2011) një poç elektrik i zakonshëm qëndron rreth 1000 orë, përderisa një poç elektrik eficient qëndron 6000 orë, gjë që e kompenson diferencën në kosto që është afërsisht gjashtë herë më e madhe. Pra përfitimet nga përdorimi i poçave eficient në periudha afatgjate tejkalojnë ndjeshëm koston fillestare të instalimit. Përdorimi i poçave eficient është i rëndësishëm edhe nëse shikohet nga perspektiva e integritimit Evropian. Bashkimi Evropian në 2012 parasheh që të ndaloj shitjen dhe përdorimin e poçave elektrik të zakonshëm, rrjedhimisht Kosova duhet të konsideroj edhe këtë parametër shumë të rëndësishëm.

b) Izolimi- Izolimi i ndërtesave përfshin: izolimin e mureve, ndërrimin e xhamave të zakonshme me ato termike (double-glazing), ndërrimin e dymave dhe izolimin e kulmit. Izolimi i mirëfilltë, natyrisht pa pasur ndikim në kualitetin e ajrit brenda objektit, mund të reduktoj deri në 30% konsumin e energjisë elektrike. Mirëpo, kjo shifër vlen për ato ndërtesa të cilat si burim të ngrohjes e kanë rrymën elektrike e jo drurin, gazin apo burimet tjera të ngrohjes. Izolimi i ndërtesave në Kosovë është esencial duke pasur parasysh se më shumë se 30% e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë shfrytëzohet për ngrohje (Qendra për Energji dhe Burime Natyrore 2011). Kjo përqindje mund të jetë më e madhe nëse përfshihen edhe sektorët e tjerë si ndërmarrjet private dhe sektori publik të cilat përdorin energjinë elektrike për ngrohje. Sipas Riinvest (2010), nëse të gjitha shtëpitë dhe banesat do të izoloreshin, atëherë do të mund të kurseheshin rreth 487 GWh në vit apo rreth 24 milion Euro.

c) Menaxhimi i ndriçimit nënkupton instalimin e ndërprerësve automatik nëpër amvisëri dhe ndërtesa administrative. Pra, në raste kur nuk është askush prezent në dhomë apo zyre të ndërtesës, atëherë dritat fiken automatikisht. Edhe kjo kontribuon në një zvogëlim të konsiderueshëm të shpenzimit të energjisë elektrike për nevojat e ndriçimit. Instalimi i sensorëve në vende të ndryshme të botës ka rezultuar me një zvogëlim të moderuar të shpenzimeve të energjisë elektrike.

4. Humbjet komerciale dhe teknike

Humbjet komerciale dhe teknike paraqesin edhe një grup tjetër problemesh për sa i përket shfrytëzimit të energjisë elektrike në Kosovë. Sipas MEM (2009), si linjat ashtu edhe trafostacionet në nivele të ndryshme të tensionit janë të ngarkuara tepër e posaçërisht gjatë muajve të dimrit. Kjo mbingarkesë reflektohet me ndërprerje të shpeshta dhe me humbje teknike të mëdha të cilat gjatë vitit 2008 ishin afërsisht 17% e nivelit të përgjithshëm të energjisë të prodhuar dhe importuar (MEM 2009). Në anën tjetër, humbjet komerciale janë edhe me të larta. Po i njëjti raport i MEM tregon që gjatë vitit 2008 humbjet komerciale ishin afërsisht 25%. Krahasuar me vitet e kaluara këto humbjet komerciale kanë rënë (në 2007, afër 30%), megjithatë përqindja e tërësishme mbetet prapë shumë e lartë. Një raport tjetër nga Bashkimi Evropian tregon që humbjet si shkak i mos mbledhjes së pagesave për energji elektrike në vitin 2008 janë afër 36 milion euro.

Humbjet si shkak i mos mbledhjes së pagesave për energji elektrike në vitin 2008 ishin afër 36 milion euro

Mos faturimi i energjisë së prodhuar dhe të importuar të futur në sistemin energjetik të Kosovës, ka krijuar vështirësi të shumta si për korporatën energjetike ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Paaftësia e faturimit dhe inkasimit të plotë është shkaktuar nga shumë faktor, përfshirë: organizimin e brendshëm të KEK-ut dhe keq-menaxhimin e saj, sistemin joefikas gjyqësor, vetëdijen e ultë të konsumatorëve, shtrirjen jo të plotë e autoritetit në tërë Kosovën (në mënyrë të veçantë veriu dhe enklavat serbe) si dhe mungesën e vullnetit të qeverive dhe strukturave ndërkombëtare për ta zgjidhur këtë çështje. Ngritja e efikasitetit në evitimin e humbjeve komerciale si dhe të atyre teknike, sipas vlerësimeve të KEK-ut, do të mund të kursente rreth 40% të energjisë së prodhuar dhe importuar. Një prej parakushteve teknike për tejkalimin e kësaj situatë është liberalizimi i tregut në nivel të distribucionit të dhe përdorimi i njehsorëve digjital.

5. Ndërtimi i kapaciteteve të reja të mbështetura në energji të ripërtëritshme

Potencialet e Ujit

Edhe uji konsiderohet si një burim i rëndësishëm prej të cilit Kosova mund të përfitoi sa i përket prodhimit të energjisë elektrike. Sipas disa studimeve të bëra nga ekspertë të Shqipërisë, në Kosovë në vitin 2006, janë identifikuar rreth 18 vende potenciale për të ndërtuar hidroelektrana të vogla. Kapaciteti i instaluar i tyre pritet të jetë rreth 58 Më. Më vonë, në vitin 2009, është bërë edhe një studim tjetër ku janë identifikuar edhe 20 vende të tjera potenciale anë e mban Kosovës. Kapaciteti i tyre pritet të jetë më i vogël se ai i lokacioneve të para: 22 Më. Së fundi, në vitin e kaluar është bërë edhe një studim nga ekspertë të Shqipërisë që nxjerr edhe 41 hidroelektrana potenciale me kapacitet 50 Më.

Këto vende do të jenë të shpërndara në 16 lumenjë: Iber, Llapi, Klina, Lumi Morava e Binçës, Istogu, Nerodime, Çajlanë, Sîtnice, Lumi Rekë e Aliagës, Drini i Bardhe, Drini i Bardhe – Jabllanica, Lepenci pjesa e poshtme, Prizreni, Peja, Llocani. Kapaciteti i përgjithshëm i të gjitha këtyre hidroelektraneve të vogla pritet të jetë dikund 131 MË apo me pak se 1/10 e kërkeses aktuale të energjisë elektrike në Kosovë.

Siç është paraparë, kostoja e investimit për të gjitha këto hidroelektrana të vogla, nuk do të kalojë shumen e 162 milion eurove. Meqë asnjëra nga këto nuk do t'a kalojë fuqinë e 5MË-ve atëherë nuk ka nevojë për penda të mëdha, faktor shumë e rëndësishme për të mos e dëmtuar botën ujore. Me poshtë në tabelë janë të paraqitura të dhënat e përmbledhura. Siç është prezantuar edhe më lartë, vendet janë identifikuar, studimet janë bere, vetëm se po mungon vullneti i institucioneve tona për të ndërmarr ndonjë hap për të filluar ndërtimin e tyre.

PARAMETRAT BAZË	2006	2009	2010	TOTAL
NUMRI I HEC-EVE TË EVIDENTUARA	18	20	41	79
FUQIA, MW	58.6	22.6	50	131.2
ENERGJIA, GWH/VIT	270	110	253	633
INVESTIMI, MEURO	64.46	47.18	50.86	132.5
VLERA E ENERGJISË (CMIMI 55 EURO/ MWH), MEURO	15.5	6.5	14.5	36.5
PERIUDHA E VETESHLIJES MESATARE E INVESTIMEVE, VITE	5.72	7.98	4.82	6.12

Përveç këtyre, edhe hidrocentrali i Zhurit paraqet një mundësi të mirë që të prodhohet një sasi e madhe e energjisë elektrike. Kjo hidroelektranë pritet të jetë hidroelektrana më e madhe e ndërtuar ndonjëherë në Kosovë me një kapacitet të instaluar prej 300 MË. Ndërtimi i kësaj hidroelektranë të madhe kërkon një analizë të detajuar në mënyrë që të implementohet dhe të jetë në të mirë të qytetarëve.

Energjia Solare

Energjia solare/diellore, si burim i ripërtëritshëm, duhet të konsiderohet si një alternativë për të zvogëluar konsumin e energjisë elektrike në Kosovë që kryesisht vjen nga linjiti. Fakti që Kosova konsiderohet të ketë afërsisht 278 ditë me diell tregon që ky vend ka predispozita të qarta për shfrytëzimin e këtij burimi. Poashtu, edhe intensiteti i rezeve gjatë këtyre ditëve konsiderohet të jetë i ngjashëm me vendet të cilat vetëm kanë filluar të instalojnë panele solare. Sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, gjatë vitit në Kosovë mund të prodhohen afërsisht 1,100 deri 1,250 KËh për m².1 Megjithatë, vendosja e paneleve solar dhe poqave në fillim kushton shumë, efektet e tyre vërehen pas një kohe me kursimin e parave përgjatë viteve të shfrytëzimit të atyre paneleve. Është karakteristike që panelet solare qëndrojnë gjatë dhe kërkojnë shumë pak mirëmbajtje.

Energjia e Erës

Energjia e Erës përfaqëson një potencial të mirë të prodhimit të energjisë, dhe se shfrytëzimi i saj konsiderohet si një prioritet në drejtim të mbrojtjes së ambientit në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, studimet e bëra deri më sot dhe të bazuara në të dhënat nga instituti hidrometeorologjik, tregojnë se Kosova për fat të keq, në masë të madhe, nuk e ka shpejtësinë e duhur të erës për të prodhuar energji. Për më tepër, instalimi i turbinave dhe gjeneratorëve të erës, përcillet me kosto të lartë dhe për pasojë çmimi i energjisë së prodhuar përmes erës mund të mos jetë konkurrues përballë energjisë së prodhuar nga burimet tjera (në mënyrë të veçantë nga thëngjilli) (Dragusha, et al., 2009).

*Deani vend i
përshtatshëm për
ndërtimin e 150
turbinave të erës*

Mirëpo, pavarësisht kësaj, investitorë të ndryshëm në Kosovë kanë bërë instalimin e kapacitete të para prodhuese në këtë drejtim. Investimi i parë është bërë në kodrën e Goleshit, nga një shoqëri aksionare shqiptaro-gjermane "Wind-Power", e cila kompani ka vendosur tre gjeneratorë të erës me një kapacitet momental prej 1.35 MW (KOSOVA PPESS 2010). E njëjta kompani planifikon që gjeneratorë të ngjashëm të vendosen edhe në Artanë, Rahovec, Ferizaj dhe Gjiilan. Gjithashtu, kompania bleje "Belenergy" është koncentruar në Deçan si një vend të përshtatshëm për ndërtimin e 150 turbinave të erës, të cilat pritet të prodhojnë energji për tërë regjionit e Dukagjinit. Ky projekt është në fazën fillestare ndërsa efektet pritet të shihen më vonë. Pra, edhe pse energjia e erës nuk paraqet ndonjë burim në të cilin mund t'i mbështesim nevojat e përgjithshme, megjithatë kjo mund të shfrytëzohet si një alternativë e rëndësishme për prodhimin e energjisë elektrike.

Energjia Gjeotermike

Energjia gjeotermike, si energji që del nga toka dhe që nuk emeton gazra të cilët e ndotin ambientin, hyn në kategorinë e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Në Kosovë, energjia gjeotermike ka filluar të përdoret vetëm viteve të fundit dhe niveli i investimeve në këtë lloj energjie është shumë i ulët dhe i kufizuar kryesisht në investime private. Përkundër kostonë së lartë fillestare që kërkon instalimi i sistemit gjeotermik, dobitë në një periudhë afatgjate e tejkalojnë këtë kosto. Kthimi i investimeve në instalimin e sistemit gjeotermik llogaritet të jetë 4 deri në 5 vite, varësisht prej kapacitetit të instalimit. Sipas një studimi të bërë nga Riinvesti, zëvendësimi i energjisë elektrike me atë gjeotermike do të rezultonte me një zvogëlim të shpenzimeve të ngrohjes për katër herë. Nëse një zëvendësim i tillë do të bëhej në nivel vendi, atëherë një pjesë e konsiderueshme e energjisë elektrike e cila do të përdorej për ngrohje do të mund të kursehej.

Përfundimi

Diskutimi në panel

Justina Pula (deputete - ish minister)

Justina Pula e hapi fjalimin e saj duke thënë se njëra nga shtyllat kryesore për një zhvillimit të qëndrueshëm është mosndotja dhe mos rrezikimi i mundshëm gjeneratave të reja. Nëse duhet të shfrytëzohen burimet fosile, atëherë këto duhet të shfrytëzohen me një teknologji të avancuar. Ajo vazhdoi duke thënë se e ardhmja e Kosovës është në burimet e ripërtërishme dhe në efikasitet të energjisë. Ajo theksoi, "Duhet me i dhënë rëndësi edhe ujit, erës dhe diellit."

Sipas Justina Pules, baza ligjore ekziston vetëm se mbetet të implementohet. Ajo propozoi që të rriten kapacitetet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik – Departamenti i Energjetikës në mënyrë që të implementohen ligjet e aprovuara. Ajo tha që duhet të plotësohen direktivat të parashtruara nga Bashkimi Evropian 20,20, 20 (deri në vitin 2020, 20 % e energjisë së përgjithshme duhet të jetë e prodhuar nga burimet e ripërtërishme si dhe për 20 % duhet të reduktohet emetimi i CO₂). Znj Pula e mbylli fjalimin e saj duke thënë se më shumë duhet të punojmë me bashkësinë ndërkombëtare në mënyrë që t'i përmbushim kërkesat e parashtruara nga Traktati për Komunitetin e Energjisë.

Ruzhdi Sefa (UP – shoqëria civile)

Sipas Ruzhdi Sefës, mungon një koordinim pragmatik. Edhe profesori i dha rëndësi promovimit të energjisë së ripërtërishme. Ai theksoi, "Shteti duhet të subvencionon energjinë e erës." "Ministria, zyra e rregullatorit dhe qeveria ne përgjithësi me shume duhet të bëjë për të përmirësuar gjendjen e energjetikës," përfundon ai.

Visar Kelemendi (Shoqëria civile)

Visar Kelmendi tha që direktivat e Bashkimit Evropian janë të obligueshme dhe duhet të plotësohen nëse e synojmë Bashkimin Evropian. Ai tha se prodhuesit e energjisë elektrike të pavarur do të ndihmonin shumë në liberalizimin e tregut i cili është kusht kryesor për avancimin e sektorit të energjisë. "Qeveria duhet të ketë një qasje me proaktive në promovimin e qasjeve alternative që po përmenden," shton ai. Konkurrenca duhet të jete çelësi kyç për zhvillimin e sektorit të energjetikës.

Diskutimi i hapur:

Luan Morina (Ministria e Zhvillimit Ekonomik)

Luan Morina theksoi që aspekti ekonomik, teknik, social dhe shume aspekte te tjera janë të rëndësishme për fuzionimin e sistemeve energjetike në mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Ardian Berisha (ZRrE – Zyra e rregullatori të energjisë)

Ardian Berisha theksoi që si rezultat i skemave nxitëse, investitorë të ndryshëm te interesuar për të ndërtuar 100 MW kanë ardhur për të kërkuar autorizim prej zyrës se rregullatorit. “Energjia e ripërtrishme edhe pse e mirë për ambientin, paraqet një barrë për gjepin e konsumatorit,” përfundon ai.

Lulzim Syla (nga sektori privat)

Lulzim Syla theksoi që qeveria duhet ti ndihmojë sektorit privat për vendosjen e paneleve solare; ose duke i ulur taksat doganore për këto panele. Ai vazhdoi duke thënë se, “nëse panelet fillojnë të instalohen ne Kosovë atëherë edhe Kosova mund të fillojë të prodhojë panele te tilla të cilat përveç nevojave të veta mund edhe ti eksportoi. “Ata të cilët e paguajnë rrymën me rregull duhet të shpërblehen me nga 5 poça eficient,” vazhdon ai.

Sipas tij, kjo është një mënyrë e mire për ta stimuluar konsumatorin. Duhet të dorëzojmë projekt propozime si në nivel komunal dhe shtetëror në Komision Evropian dhe ata do të na financojnë. Rregullatori i energjetikës duhet të përcaktoj tarifat për energji gjeotermale.

Referencat

Berisha, LB 2010, 'Applying Energy Efficiency Standards in Kosovo's Residential Buildings', Masters' thesis, American University in Kosovo, Prishtine.

Bowen, BB 2011, 'Energy Efficiency, Economics and Environment' Center for Energy and Natural Resources, Prishtina, Kosova
<[http://www.rit.edu/research/cenr/documents/Workshop/DRC1,%20BH%20Boën%20March%2024\(23\),%202011.pdf](http://www.rit.edu/research/cenr/documents/Workshop/DRC1,%20BH%20Boën%20March%2024(23),%202011.pdf)>.

Dragusha, BB & Limani, Il & Rexha BB n.d., *The use of wind generators in Kosovo*, University of Prishtina, viewed 12 June 2011, <<http://fiek.uni-pr.edu/getattachment/Personeli/Personeli-akademik/Dr--techn--Blerim-Rexha/The-use-of-wind-generators-in-Kosovo-EED-24.pdf.aspx>>.

Frondel, MF & Lohmann, SL 2011, *The European Commission's Light Bulb Decree: Another Costly Regulation?* pp. 8, viewed 08 June 2011, <http://www.rwi-essen.de/media/content/pages/publikationen/ruhr-economic-papers/REP_11_245.pdf>.

Kosspres 2007, ' ', 17 February, p. 6, viewed 14 June 2011, <<http://kospress.com/portali/ekonomi/energjetike/73-energjetike/11194-ne-kosove-fillon-prodhimi-i-energji-se-elektrike-me-ere->>>.

Ministry of Energy and Mining, MEM 2010, 'Study for New Hydropower plant', Prishtina.

Ministry of Energy and Mining, MEM 2000, 'Strategjia e Energjisë të Republikës Kosovës', Prishtina.

Ministry of Public Administration (MPA) 2011, *Energy Balance in Kosovo*, viewed 13 June 2011, <<http://esk.rksgov.net/eng/dmdocuments/Energy%20Balance%20in%20Kosovo%20Q4%20-%202010.pdf>>.

Energy Community 2010, EU Report 2010, viewed 20 June 2011, <http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/EU/UNMIK/2010>.

Rreth Friedrich-Ebert-Stiftung

Si organizatë private jofitimprurëse, Fondacioni Friedrich-Ebert është zotuar të promovojë idetë dhe vlerat themelore të demokracisë sociale. Demokracia sociale bazohet në të drejtat sociale të drejtat e njeriut dhe ato civile dhe synon t'i përforcojë ato. Ajo zgjeron dhe onsolidon bazën e demokracisë politike duke e përfshirë drejtësinë sociale, demokratizimin e shoqërisë, sigurinë sociale, zhvillimin e qëndrueshëm dhe solidaritetin ndërkombëtar. Ajo mëton të sigurojë mundësi të barabarta në jetë dhe të drejtën për të pasur zë në çështjet e komunitetit të tyre për të gjithë ytetarët, burra dhe gra. Fushat kryesore të veprimit tonë janë: Promovimi i demokracisë dhe mbështetja e shoqërisë civile duke ndihmuar përfaqësuesit e institucioneve politike dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe gazetarët, akademikët dhe sindikalistët.

Avancimi i procesit të decentralizimit dhe mbështetja e qeverisjes lokale demokratike duke u mbështetur në debatet mbi konceptet e Qeverisjes së Mirë në nivel lokal dhe duke nxitur pjesëmarrjes aktive të të gjitha komuniteteve etnike në qeverinë lokale. Për më tepër, FES mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe të drejtë në aspekt social, duke mundësuar dialog social ndërmjet qeverisë, sindikatave të pavarura dhe organizatave të punëtorëve. Një synim tjetër është promovimi i integritit rajonal dhe ndërkombëtar duke e shqyrtuar procesin e integritit evropian bashkë me hisedarët. Veç kësaj, me organizatat e shoqërisë civile dhe vendimmarrësit debatohen propozimet progresive të politikave për integrimin e Kosovës në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.



Prishtina Office
Kosovo, Prishtina, Mujo Ulqinaku str. 4/10
Tel : + 381 38 609 900 & 609 901
Fax: + 381 38 609 902
e: contact@fes-prishtina.org
web: www.fes-prishtina.org

Rreth Institutit Riinvest

Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, operon që nga viti 1995 si organizatë hulumtuese, private jo-profitabile, me mision që ta promovojë zhvillimin modern ekonomik të Kosovës bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë. Aktivitetet e Riinvestit gjatë viteve 1995-1997 ishin të fokusuar në organizimin e seminareve dhe uorkshopeve me ndërmarrës në çështje të ndryshme të mjedisit të biznesit dhe menaxhmentit të biznesit. Gjatë viteve 1997-1999 Riinvesti bëri aktivitete hulumtuese dhe përkrahëse të orientuara drejt rritjes së njohurive dhe informatave mbi faktorët vendor dhe ndërkombëtarë në aspektet ekonomike të Kosovës. Gjatë periudhës së viteve 1999-2000 aktivitetet u orientuan drejt analizimit të situatave në sektorë të ndryshëm (NVM, bizneset familjare, SOE) dhe drejt një rikonstruktimi të suksesshëm. Që nga viti 2001 aktivitete kryesore përfshijnë hulumtimet mbi politikatat dhe advokime për rritjen e mjedisit të biznesit dhe krijimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Ne jemi instituti i parë për zhvillim dhe kërkim i llojit think tank në Kosovë ne funksion që nga viti 1995. Ne promovojmë zhvillimin modern ekonomik në Kosovë bazuar në filozofinë e ndërmarrjeve. Ne kemi bërë publikime ekonomike dhe raporte me tematika shumë të rëndësishme që përfshijnë emrat e profesionistëve më të kualifikuar. Ne kemi krijuar partneritete me organizata të ndryshme botërore, kryesisht me ato të Amerikës Veriore. Ne organizojmë seminare, konferenca, tryeza diskutimi, dhe takime me rëndësi dhe vlerë të lartë ekonomike për Kosovën. Dituria dhe eksperiencia jonë na lejon që të kualifikohemi si ekspert në çdo fushë ekonomike. Me punën tonë, gjatë 2 dekadave të fundit, ne kemi shkruar historinë e vendit tonë mbi ekonominë, tregtinë, ndërmarrësi, dhe biznes.



Kosovo, Prishtina, Zona Industriale, 10000
Universiteti AAB-Riinvest, Godina 2, K 4
Tel: + 381 38 601 320 & 601 321
Fax: + 381 38 601 321
e: riinvest@riinvestinstitute.org
ëëb: ëëë.riinvestinstitute.org